



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**MINISTRI**

Nr. 973 Prot.

Tiranë, 21.02 2013.

**UDHËZIM**

Nr. 3, datë 21.02 2013

**PËR**

**MASAT PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË LIRIMIT 2013**


Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe të Vendimit të Këshillit Ministrave, Nr. 1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve",

**UDHËZOJ**

1. Provimet e Lirimit 2013 të fillojnë në orën 10.00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.
2. Lëndët dhe datat e provimeve Maturës Shtetërore janë:
  - a) Gjuhë Amtare 12 qershor 2013
  - b) Matematikë 19 qershor 2013
3. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në "Rregulloren për Provimet e Lirimit 2013" Nr.154, datë 11.01.2013.
4. Në shkollat e pakicave kombëtare (greke dhe maqedonase) zhvillohet Provimi i Lirimit në gjuhën amtare.
  - a) Për shkollat e pakicës kombëtare greke teza do të përgatitet nga DAR Gjirokastrë. ZA Delvinë dhe ZA Sarandë tërheqin në DAR Gjirokastrë tezen në ditën e provimit.

- b) Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase teza përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës i shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR Korçë.
5. Për Institutin e nxënësve që nuk shikojnë, testi të tërhiqet në AKP nga drejtorja e institutit një ditë para zhvillimit të provimit, që e kthen atë në sistemin e shkrimit BRAIL.
6. Nxënësi mbetet në provimet e lirit ka të drejtën e riprovimit në sesionin e dytë.
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtorja e Programeve të Zhvillimit, Drejtorja e Shërbimeve të Brendshme, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore.

*Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare"*

MINISTRI  
  
Myqerem TAJAJ

